



## **VENDIMI MBI PAPANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 19 qershor 2019**

**Nr. i lëndës: 2016-10**

**Dragiša Kostić**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 19 qershor 2019, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues

Z. Petko PETROV, anëtar

Ndihmuar nga

Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 15 janar 2019,

### **I. PROCEDURA**

1. Ankesa në këtë lëndë është regjistruar në Panel më 30 qershor 2016.
2. Më 28 qershor 2017, Paneli ka kërkuar nga ankuesi që të ofrojë informata shtesë. Ankuesi është përgjigjur përmes përfaqësuesit të tij për të thënë se nuk kishte informacione të mëtejshme.
3. Pastaj, Paneli ka dërguar një kërkesë të mëtejshme dhe ka marrë një përgjigje nga përfaqësuesi më 20 tetor 2017, i cili ka përfshirë informacione shtesë mbi rastin.
4. Paneli ka vendosur t'i përcjellë pyetjet shifes së Misionit (ShM), EULEX-it Kosovë, duke e ftuar atë të paraqesë përgjigjet e saj dhe vërejtjet me shkrim mbi ankesat.

5. Vërejtjet e ShM-së ishin pranuar më 19 prill 2019 dhe iu ishin komunikuar ankuesit për vërejtje të tij shtesë.
6. Ankuesi nuk ka paraqitur vërejtje shtesë.

## **II. PËRBËRJA E PANELIT**

7. Pas dorëheqjes së njërit prej anëtarëve të tij përhershëm, Paneli do të mblidhet në lidhje me këtë çështje vetëm me dy anëtarë, në përputhje me rregullat 11 dhe 14 të rregullores së punës së Panelit.

## **III. QËNDRIMI I ANKUESIT**

8. Duke marrë parasysh marrëdhënien e ngushtë të familjes ndërmjet viktimës së drejtpërdrejtë - dhe parashtruesit të ankesës – d.m.th. gjyshi – i biri - Paneli është i bindur që ankuesi mund të konsiderohet viktimë dytësore e shkeljeve të supozuara dhe se si e tillë viktimë e mundshme në përputhje me rregullën 25(1) të rregullores së punës së Panelit.

## **IV. FAKTET**

9. Faktet e lëndës, siç duket nga ankesa, mund të përmbliidhen si më poshtë:
10. Me apo rreth datës 17 qershor 1999, Svetozar Stambolić, gjyshi i ankuesit Dragiša Kostić-it, pretendohet se “ishite tërhequr i gjallë” mbrapa një traktori në Maxhunaj, komuna e Vushtrrisë.
11. Banorët e fshatit ishin detyruar të iknin nga shtëpitë dhe fshatrat e tyre në atë datë, por Svetozar Stambolić-i kishte mbetur në fshat. Ai asnjëherë nuk është parë më dhe zhdukja e tij ishte raportuar tek autoritetet.
12. Kur EULEX-i Kosovë kishte ardhur për të zëvendësuar UNMIK-un në periudhën dhjetor 2008 - mars 2009, thuhet se një raport për hetimin ante mortem që i referohet zhdukjes së Svetozar Stambolić-it ishte bartur tek EULEX-i Kosovë.
13. Misioni gjithashtu thuhet se ka pranuar një formular të identifikimit të viktimave të fatkeqësive të Interpolit i plotësuar me të dhënat e tij. Raporti tregonte se UNMIK-u kishte intervistuar ankuesin dhe një anëtar tjetër të familjes së z. Stambolić përmes telefonit në një datë të pasaktësuar në vitin 2005. Anëtarët e familjes nuk mund të jepnin ndonjë informacion që mund të shpjegonte rrethanat e zhdukjes.

## **V. ANKESAT**

14. Ankuesi nuk i referohet ndonjë të drejte të posaçme themelore, por thekson se janë shkelur këto instrumente të të drejtave të njeriut si në vijim:
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948);
  - Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj, 1950);
  - Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KEDR, 1965);
  - Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar (KKT, 1984).
15. Për arsyet e përshkruara më poshtë, Paneli ka mendimin se ky rast është i pranueshëm në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të ankuesit sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe dispozita të tjera të ngjashme.

## **VI. PARASHTRIMET NGA PALËT**

### **Ankuesi**

16. Siç është përmbledhur më lart, ankuesi pretendon se, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, EULEX-i Kosovë duhet të kishte hetuar zhdukjen e gjyshit të tij dhe me faj nuk ka arritur të bënte atë në kundërshtim me të drejtat themelore të tij dhe gjyshit të tij.

### **Shefi i Misionit**

17. Në parashtrirat e saj, ShM-ja ka vënë në dukje se në momentin e dorëzimit të dosjes së lëndës nga UNMIK-u në lidhje me z. Svetozar Stambolić-in, kjo lëndë kishte qenë joaktive që nga viti 2005.
18. Sipas të dhënave të EULEX-it Kosovë, ankuesi asnjëherë nuk ka bërë ndonjë kërkesë në Mision lidhur me statusin e hetimit dhe në ankesën e tij tek PShDNj-ja, ankuesi nuk ka argumentuar se zhdukja e të afërmit të tij ishte raportuar në EULEX Kosovë ose se ai kishte bërë ndonjë hetim në këtë drejtim. Ankesa në PShDNj është parashtruar në qershor të vitit 2016, pra 17 vjet pas zhdukjes, 11 vjet pas marrjes së hapave të fundit hetimor (nga UNMIK) dhe më shumë se shtatë vjet pas fillimit të mandatit të EULEX-it Kosovë.
19. Prandaj fakti që ankuesi ka qëndruar pasiv për një periudhë të konsiderueshme kohore nuk mund të injorohet. ShM-ja thekson se parashtruesi i ankesës duhet të kishte lëvizur në një afat para vitit 2016, atëherë kur marrë parasysh mungesën e çfarëdo komunikimi nga UNMIK-u apo autoriteteve të EULEX-it duhet të kishte dyshuar se hetimi kishte kaluar

në mosveprim dhe se nuk kishte ndonjë perspektivë realiste se ndonjë hetim do të zhvillohej në një të ardhme.

20. ShM-ja paraqet se kjo vonesë nga ana e ankuesit për të bërë ndonjë kërkesë duhet të karakterizohet si e tepruar dhe e pashpjeguar dhe për këtë arsye kërkon nga Paneli që ankesa të shpallet e papranueshme.

### **Përgjigja e ankuesit**

21. Ankuesi nuk iu është përgjigjur vërejtjeve të ShM-së.

## **VII. VLERËSIMI I PANELIT**

*Mandati i Panelit (rregulli 25, paragrafi 1 i Rregullores së Punës) dhe kufizimet e natyrshme të vendosura në Mision në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut*

22. Si një çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohet në Konceptin e Përgjegjshmërisë të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet juridike demokratike.
23. Para shqyrtimit të ankesës në bazë të meritave të saj, Paneli duhet të vendosë nëse do të vazhdojë me ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullën 29 të rregullores së punës.
24. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv.
25. Paneli tashmë ka vendosur se veprimet e prokurorëve dhe policisë së EULEX-it në parim janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe për këtë arsye bien në kuadër të mandatit të Panelit (shih, për shembull, K deri T kundër EULEX-it, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, par. 43, Krlc kundër EULEX-it, 2012-21, 26 gusht 2014, paragrafi 23, Y kundër EULEX-it, 2011-28, 15 nëntor 2012, paragrafi 35).
26. Paneli tashmë ka pasur rastin të theksojë se misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe se aftësia e saj për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohet në të gjitha aspektet relevante me atë që mund të pritët nga një shtet (shih vendimin e Panelit në A, B, C, D kundër EULEX-it, 2012-09 në 2012-12, 20 qershor 2013, paragrafi 50, K-T kundër EULEX-it, cituar më lart, paragrafi 53, shih gjithashtu vendimin e PKDNj-së në lëndët 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, paragrafi 35).
27. Paneli gjithashtu merr parasysh vështirësitë e përfshira domosdoshmërisht në hetimin e krimeve në një shoqëri pas konfliktit si Kosova (shih Palic kundër Bosnjë dhe

Hercegovinës, aplikacioni 4704/04, aktgjykimi i 15 shkurtit 2011, par. 70; Vendimi i PKDNj-së në lëndët 248/09, 250/09 dhe 251/09, të cituar më lartë, paragrafët 44 dhe 62 e tutje). Megjithatë këto vështirësi nuk duhet të shërbejnë për të maskuar apo justifikuar dështimet që nuk kanë ndonjë kuptim me këto vështirësi. Prandaj Paneli do të vlerësojë në secilin rast nëse një hap i veçantë hetimor që normalisht ishte i hapur në EULEX do të ishte bërë jopraktik nga arsyet që lidhen me rrethanat e pas konfliktit, pavarësisht nga ata që kryejnë hetimin (shih vendimet në lëndën HRRP nr. 2014- 32, LO kundër EULEX-it, par. 44 dhe lënda nr. 2014-34 Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it par. 31, (citur).

28. Prandaj pritjet e vëna mbi aftësinë e EULEX-it për të hetuar dhe për të zgjidhur lëndë të ndërlikuara penale duhet të jenë realiste. Pra Paneli nuk do të vendos mbi misionin një barrë disproporcionale që mandati dhe burimet e saj nuk janë të gjendje të përmbushin (shih vendimin e PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, §§ 70-71). Shih gjithashtu nenet nr. 2014-11 deri 2014-17, para 56, Veselinović dhe të tjerët kundër EULEX-it, si dhe nr. 2014-32 Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it para 30. Në çdo rast, pritjet nga Paneli që të shqyrtoj nëse ka pasur pengesa konkrete dhe reale që mund të kenë dëmtuar mundësinë që EULEX-i ta kryente ndonjë hetim të shpejtë dhe efektiv të një lënde. Një vlerësim i tillë nuk ka për qëllim që të arsyetoj të metat operacionale që nuk kanë të bëjnë me sfidat konkrete dhe të demonstrueshme, por për të siguruar se Misioni nuk pritjet të bëjë më shumë sesa në mënyrë të arsyeshme do ta lejonte mandati dhe burimet e veta.
29. Në çdo rast, në veçanti në rastet e këtij serioziteti, autoritetet hetimore priten të veprojnë shpejt për aq sa është e arsyeshme dhe të përdorin burime në përputhje me nevojën dhe mundësinë për zgjidhjen e lëndës. Përderisa autoritetet hetuese nuk mund të priten t'i zgjidhin të gjitha lëndët e parashtruara pranë tyre, prej tyre pritjet që në çdo rast të veprojnë me zell, shpejtësi dhe efikasitet të tillë që e pasqyrojnë seriozitetin e lëndës, e cila është duke u hetuar (*shih Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë [GC], § 191, KEDNj 2009; Palic kundër Bosnjë dhe Hercegovinës, cituar më lartë, § 63*), si dhe rastet nr. 2014-11 deri 2014-17, para. 65, Veselinović dhe të tjerët kundër EULEX-it, lënda nr. 2014-18, par. 56, Maksutaj kundër EULEX-it dhe lënda nr. 2014-32 L.O. kundër EULEX-it, par. 46.
30. Një angazhim dhe përkushtim i rreptë me këto standarde është veçanërisht i rëndësishme për një mision të sundimit të ligjit si EULEX që ka për qëllim të shërbej si shembull i përkushtimit të shoqërisë për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe për ndërtimin e një ndjenje të fortë të përgjegjësisë ndaj shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Çfarëdo standardi më pak se ky do të rrezikonte krijimin e një ndjenje pajtimi me mosndëshkimin dhe mospërfilljen e kërkesës legjitime të viktimave për drejtësi dhe llogaridhënie (shih vendimin e PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, § 80), përveç lëndëve nr. 2014-11 deri 2014-17, par. 64, Veselinovic dhe të tjerët kundër EULEX-it.
31. Në kontekstin e tanishëm, Paneli është i bindur që kjo lëndë vjen *prima facie* brenda kompetencës së tij *ratione materiae* dhe vë në dukje se Misioni nuk ka pasur mospajtime me atë pjesë të kërkesës.

*Lidhja e mjaftueshme kohore me sjelljen themelore dhe afatin 6 mujor për parashtrimin e një ankese - Kompetenca e Panelit ratione temporis.*

32. Siç është cekur më lart, ShM-ja parashtroi që Paneli nuk ka juridiksion *ratione temporis* mbi lëndën dhe/apo se ankuesi nuk ka arritur të përmbushë afatin prej 6 muajsh brenda të cilit do të dejtë parashtrorë ankesë në pajtim me rregullën 25, paragrafi 3 të rregullores së punës së Panelit.
33. Në pajtim me rregullin 25, paragrafi 3, të rregullores së punës së Panelit, ankuesit i kërkohet të paraqesë ankesë brenda gjashtë muajve nga veprimi, vendimi ose sjellja që thuhet se përbëjnë ose përfshijnë shkelje të të drejtave të tij/saj (shih, p.sh. Gashi kundër EULEX-it, 2013-22, 7 prill 2014, paragrafi 10, Thaqi kundër EULEX-it, cituar më lart, paragrafi 51).
34. Si çështje paraprake, Paneli thekson që Misioni në dukje ishte vënë në dijeni për ekzistencën e këtij rasti kur mori njoftimin nga UNMIK-u. Pa paragjykuar meritën e rastit, nga ajo pikë e tutje, ai kishte detyrimin ta hetonte çështjen. Ky detyrim ishte, *prima facie*, në vazhdim e sipër. Nuk varej nga ankuesi që tu kërkonte atyre të vepronin apo që ndryshe të kërkonin nga Misioni.
35. Paneli pajtohet me Misionin se një shkallë e proaktivitetit pritet nga ana e viktimave të supozuara të shkeljeve të të drejtave të njeriut kur bëhet fjalë për të kërkuar për t'i korrigjuar ato shkelje. Se sa proaktive dhe se si kjo duhet të vlerësohet varet nga rrethanat e veçanta të rastit.
36. Paneli gjithashtu thekson që shkeljet e ankimura konsiderohen si shkelje në vazhdim e sipër ose të vazhdueshme të të drejtave themelore të viktimës. Shih Miladinović kundër EULEX-it, Vendim për Pranueshmëri, 2017-02, 27 mars 2019, para. 47; D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi për Pranueshmëri, 30 shtator 2015, par. 78; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendim për Pranueshmëri, 29 shtator 2015, par. 35 dhe 42. Shih gjithashtu, në kontekstin e nenit 3, GjEDNj-së, Kurt kundër Turqisë, vendimi i 25 majit 1998, Raportet e Vendimeve dhe Vendimeve 1998 III, par. 130-34; Khadzhaliev dhe të tjerët kundër Rosisë, Kërkesa nr. 3013/04, aktgjykimi i 6 nëntorit 2008, par. 120-121; Timurtas kundër Turqisë, Aplikimi nr. 23531/94, Aktgjykimi i 13 qershorit 2000, par. 95; dhe Rezoluta nr. 828 e 1984, paragrafi 3 (Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës).
37. Paneli gjithashtu do të përsërisë këtu gjetjet e tij nga lënda Miladinović, të cilat vlejné për çështjen në fjalë. Shih *Miladinovic kundër EULEX-it*, Vendimi për Pranueshmëri, 2017-02, 27 mars 2019, par. 50 e tutje, në veçanti, par. 55. Ankesat e paraqitura jashtë afatit kohor gjashtë mujor të përcaktuar sipas rregullave në parim do të shpallen të papranueshme në përputhje me rregullën 29(c) të rregullores së punës. Shih *Mikic kundër EULEX-it*, 15 qershor 2015, par. 8-9; *K.P. kundër EULEX-it*, 21 prill 2015, par. 15; *Martinovic kundër EULEX-it*, 23 nëntor 2011, par. 17-18. Sidoqoftë, në disa raste Paneli ka ushtruar lirinë e tij për të deklaruar ankesat e pranueshme që janë parashtruar me vonesë, por kur rrethanat e veçanta që kanë të bëjnë me rastin justifikojnë që çështja të mos shpallet e papranueshme për këto arsye. Serioziteti i veçantë i shkeljes së pohuar ose besimi nga ana e ankuesit se çështja ishte ende duke u shqyrtuar nga Misioni janë konsideruar si veçanërisht relevante në këtë drejtim nga Paneli. Shih p.sh. *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 29 shtator 2015, par. 44 e tutje.; *D.W. dhe të tjerët kundër EULEX-it*, 30 shtator 2015, par. 91 e tutje.

38. Për më tepër, Paneli ka konstatuar se nëse shkelja e të drejtave themelore është duke vazhduar, afati prej 6 muajsh në parim nuk ka kaluar derisa shkelja të pushojë. Shih, për shembull, *Zahiti kundër EULEX-it*, 7 qershor 2013, par 42. Në një rast të tillë, afati fillon nga data kur veprimi i kundërshtuar thuhet se ka shkaktuar ose ka rezultuar në shkelje të së drejtës. Shih, për shembull, *Y kundër EULEX-it*, 15 nëntor 2012, paragrafët 30-31. Duhet gjithashtu të kujtojmë në këtë kontekst se EULEX-i Kosovë është mision i sundimit të ligjit, jo një shtet dhe se pajtueshmëria me detyrimet e të drejtave të njeriut përbën një element thelbësor dhe thelbësor të misionit të tij (shih *Miladinović kundër EULEX-it*, Vendim mbi Pranueshmërinë, 2017- 02, 27 mars 2019, paragrafi 55).
39. Sa i përket zbatimit të parimeve dhe konsideratave të mësipërme në rastin në fjalë, Paneli thekson si në vijon. Deri në atë pikë, ankuesi nuk kishte marrë asnjë informacion nga Misioni se ishte duke ose nuk ishte duke e hetuar rastin. E as që duket se a e kishte kontaktuar ankuesi Misionin për të pyetur rreth kësaj çështjeje.
40. Misioni nuk e kundërshton sugjerimin se do të kishte qenë kompetent për të hetuar këtë rast po qe se do të kishte në posedim informacione shtesë. Në mungesë të një informacioni të tillë, rasti a mbetur pasiv. Në asnjë pikë nuk duket se rasti ishte mbyllur zyrtarisht nga Misioni. E as ankuesi nuk ishte informuar rreth këtij fakti. Mbi këtë bazë, ankuesi mund të ketë pasur përshtypje dhe të supozonte se EULEX-i do të merrej me këtë rast.
41. Megjithatë dështimi i tij për të pyetur Misionin sugjeron se ai mund të kishte qenë më aktiv në kërkimin e sqarimeve nga Misioni. Sikur ta kishte bërë këtë, ai mund të bënte që Paneli ta adresonte këtë në një fazë më të hershme.
42. Gjatë vlerësimit se çfarë pasoja lidhen me atë dështim, Paneli ka vërejtur dështimin e dukshëm të vetë Misionit për të informuar ankuesin lidhur me faktin se ka në posedim disa informata lidhur me këtë rast dhe se çështja ishte pasive në regjistrat e veta.
43. Në këtë vlerësim, Paneli gjithashtu thekson që sipas OPLAN-it të rishikuar, siç pasqyrohet në rregullën 25(4) të rregullores së punës së Panelit, ankesat në lidhje me lëndët e transferuara nga EULEX-i tek institucionet e Kosovës duhet të dorëzohen brenda gjashtë muajve nga përfundimi të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në sistemin e drejtësisë penale siç është përcaktuar në ligjin e Kosovës ose brenda gjashtë muajve nga transferimi i dosjes së lëndëve. Sipas këtij regjimi, afati i fundit për paraqitjen e një ankese nuk kishte skaduar ende në kohën kur ishte paraqitur kjo ankesë.
44. Për më tepër, vonesa në paraqitjen e ankesës siç pretendohet nga ana e Misionit nuk ka shkaktuar ndonjë dëm për sa i përket procedurave në Panel. Interesi që Misioni mund të ketë në zbatimin e rreptë të afatit prej 6 muajsh duhet gjithashtu të interpretohet në këtë aspekt.
45. Prandaj, duke zbatuar standardin e përshkruar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në *aktgjykimin Varnava*, vonesa e llogaritur ndaj ankuesit nuk mund të thuhet të jetë e tepruar ose e pashpjegueshme pasi ankuesi ka vazhduar t'i nxiste dhe kontaktonte ato autoritete, të cilat ajo ka menduar se do t'i ndihmonin ta çonte përpara këtë hetim. *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, Lëndët nr. 16064/09 e tutje, Aktgjykim, 18 shtator

2009 (siç është diskutuar në *Miladinović kundër EULEX-it*, Vendimi për Pranueshmëri, 2017-02, 27 mars 2019).

46. Në këto rrethana, Paneli është i bindur që ankuesi ka vepruar me zell dhe se afati prej 6 muajsh i përcaktuar sipas rregullave në këtë rast është përmbushur.
47. Për shkak se mosveprimi nga ana e ankuesit mund të jetë relevant sa i përket ndihmës që Paneli mund të përgatitet të ofroj në këtë rast nëse konstatohet se të drejtat e ankuesit janë shkelur nga Misioni, Paneli kërkon nga parashtruesi i ankesës të ofroj shpjegime në lidhje me mosveprimin e tij për të vepruar kur adresoheshin meritat e këtij rasti (shih pyetjen më poshtë në dispozitiv).
48. Paneli thekson që *ratione temporis* është kompetente të shqyrtojë veprimet e Misionit deri më 14 qershor 2018. Pas kësaj date, Misioni nuk kishte ndonjë përgjegjësi ekzekutive mbi këtë rast. Megjithatë aktivitetet e kryera pas kësaj date mund të jenë relevante për të vlerësuar shkallën në të cilën Misioni ka përmbushur detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut. Rrjedhimisht, Paneli fton që Misioni të bëjë referenca në parashtrimet e tij për çdo përpjekje të ndërmarrë nga Misioni për të siguruar se ky rast është duke u hetuar (nëse ka), përfshirë pas kësaj date ose çfarëdo hapi tjetër që merret nga Misioni për përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut.

## **PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI**

**SHPLL TË PRANUESHME**, pa paragjykuar meritat e çështjes, ankesat lidhur me shkeljet e pretenduara të neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

**KËRKON** nga palët që t'iu adresohen pyetjeve vijuese:

1. Për shëfen e Misionit:
  - i. A ishte Misioni në dijeni për këtë rast? Nëse po, në cilat rrethana u njoftua për këtë?
  - ii. A ka marrë Misioni, siç pretendon ankuesi, një raport ante-mortem dhe një formular të viktimës së UNMI-ut nga UNMIK-u? Nëse po, kur dhe në të cilat rrethana?
  - iii. Cilat hapa, nëse ka, i ka ndërmarrë Misioni për të hetuar këtë rast?
  - iv. Çfarë kontakte, nëse ka, ka pasur Misioni me të afërmit e të zhdukurve dhe në veçanti, me ankuesin?
  - v. A i ka mbajtur Misionin të informuar të afërmit e të zhdukurve në lidhje me përpjekjet e tyre hetimore (nëse ka)? Nëse po, kur, përmes çfarë mënyre dhe çfarë informacioni ishte ofruar?



- vi. A ishte transferuar dosja e lëndës lidhur me këtë rast tek autoritetet vendore?  
Nëse po, kur?

2. Për ankuesin:

- i. Çfarë kontaktesh, nëse ka pasur, keni pasur me Misionin EULEX apo përfaqësuesit e tij? Nëse po, kur? Nëse jo, pse?
- ii. A jeni në dijeni rreth ndonjë përpjekjeje nga autoritetet vendore për të hetuar këtë rast?
- iii. A ka bërë shkelje Misioni apo a ka kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës? Nëse po, në çfarë mënyre?
- iv. Çfarë janë pasojat - personale, financiare dhe emocionale – që lidhen me zhdukjen e të afërmit tuaj?

**DHE KËRKON** nga palët që të përgjigjen çfarë u përmend më sipër dhe të ofrojnë ndonjë parashtrësë shtesë lidhur me meritat e këtij rasti jo më vonë se më 19 shtator 2019.

Për Panelin

Z. Guénaël METTRAUX  
Kryesues

Z. Petko PETKOV  
Anëtar zëvendësues